

## AKT THEMELIMI

### PER KRIJIMIN E SHOQERISE "HERMES" SH.P.K.



Sot ne daten 20/07/2000, nga ortaku i vetem Arben Ahmetaj, krijohet shoqeria me p[er]gjegjjesi te kufizuar "HERMES" Sh.P.K., sipas kushteve te meposhtme.

#### NENI 1

Personat fizik i siperpermendur me vullnetin e tij te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar vendosi qe te krijojte shoqerine me pergjegjjesi te kufizuar me emertimin "HERMES" SH.P.K. me kapital themeltar 100.000 lke.

Kjo shoqeri e ka seline ne adresen: Rr. "Ismail Qemali", Nr.2 7, Qendra e Biznessit "Noli", Nr. 27, Tirane, Shqiperi.

Administrator i shoqerise do te jete :

1. Arben Ahmetaj

Shoqeria "HERMES" SH.P.K. ka te drejte te krijojte filialet e saj dhe te marre pjese ne shoqeri te tjera brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe do te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente kur eshte e nevojshme.

#### NENI 2

Shoqeria "HERMES" SH.P.K. gezon statusin e personit juridik.

Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statuitit (te dyja se bashku te quajtura Aktet e themelimit) dhe legjislacionit ne fuqi. Statuti i shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese integrale e saj.

#### NENI 3

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin dhe licensat e marra nga organet perkatese te gjyqesorit dhe administrativit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohore mbi 10 vjet.

Shoqeria mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate neqoftese ortaket me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjasin kete afat.

Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj edhe para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni ne se per kete marrin vendim unanim te gjithe ortaket qe bejne pjese ne kete shoqeri.



#### NENI 4

Shoqeria "HERMES" SH.P.K. do ta kete objektin e aktivitetit te saj ne fushen e:

- Telekomunikacioneve;
- Eksport-importit;
- Argetimit, televizionit me prodhim dhe transmetim programesh;
- Ndertimit;
- Restorantit;
- Konsulences financiare.

#### NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise "HERMES" SH.P.K. perbehet nga te holla qe kapin vleren 100.000. leke

Kapitali i mesiperem eshte kontribuar nga ortaku i vetem dhe zoterohet teresisht prej tij.

Kapitali i shoqerise eshte depozituar ne llogarine e shoqerise prane nje Banke.

#### NENI 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie do te ndahet midis ortakeve ne perputhje me kontributin e tyre respektiv, ne kapitalin e Shoqerise.

#### NENI 7

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, shoqeria "HERMES" SH.P.K pergjigjet vetem me kapitalin e saj dhe jo me pasurine individuale te ortakeve.

#### NENI 8

Nuk mund te pranohet si ortak ne kete shoqeri nje person i trete, pa patur pelqimin e tre te katertave te ortakeve te tjere. Si rregull i pergjithshem ortakut nuk mund te transferoje lirisht pjesen e tij te kapitalit pa marre me perpara pelqimin e ortakeve te tjere. Ai eshte i detyruar qe para se transferoje pjesen e tij te kapitalit, ta ofroje ate ortakeve te tjere. Vetem ne rastet kur ortakut e tjere nuk e pranojne blerjen ose nuk japin pergjigje brenda 90 diteve nga data e berjes se ofertes, atehere ortakut eshte i lire te ransferoje lirisht pjesen e tij.

NENI 9

Ortakët janë të detyruar të ruajnë karakterin konfidencial të aktivitetit të shoqërisë. Ortaku që shkel detyrimin e mesipër dhe nga kjo shkelje, shoqërisë ose ortakut tjetër i shkaktohet një dëm, ai është i detyruar të shpërblejë dëmin.

NENI 10

Marredheniet e punës që do të lindin midis shoqërisë dhe personave të punësuar prej saj do të rregullohen sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konfliktet që lindin ndërmjet ortakëve do të zgjidhen në marrëveshje ndërmjet tyre. Në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e rrethit Tiranë dhe ligji i zbatueshëm do të jetë ai shqiptar.

ARBEN AHMETAJ Ahmetaj

Nga: ARBEN AHMETAJ

Titulli: ADMINISTRATOR DHE ORTAK I VETEM